



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 07.07.2025

Numër Protokolli: 4605/2025

A.nr.834/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.834/2025 të datës 06.05.2025, të parashtruar nga ankuesja Xh.T-G, kundër organit të punësimit: Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.834/2025, e datës 06.05.2025, e parashtruara nga ankuesja Xh.T-G, ashtu që, detyrohet Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të rishqyrtoj kërkesën e datës 22.04.2025 të parashtruar nga ankuesja Xh.T-G dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, Xh.T-G, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 06.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë të datës 28.04.2025, të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 12.06.2025, ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja është e punësuar në Komunën e Klinës dhe se e njëjta sipas Akt emërimit me numër 02 Nr.112-29436/2024, të datës 30.08.2024, mbanë pozitën e punës *Zyrtare për Mbrojtje të Mjedisit*, në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja më datë 22.04.2025 ka parashtruar kërkesë në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, duke kërkuar korrigjimin e kategorisë profesionale, nga klasa Profesional 2 me koeficient GJ37 (4.9), në kategorinë specialist Gj13, me koeficient (6.52), ndërsa Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, përmes përgjigjes në kërkesë të datës 28.04.2025 e ka njoftuar ankuesen se Dmzp dhe Thesari, nuk e kanë zbatuar kërkesën lidhur me klasifikimin e pozitës tuaj në kategorinë Specialist.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë të datës 28.04.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, me pretendimin ankimor që ti mundësohet klasifikimi i pozitës së saj të punës nga kategoria profesionale 2 me koeficient GJ37 (4.9) në kategorinë Specialist Gj13 me koeficient (6.52). Kërkon nga këshilli që ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të nxjerrë akt emërim të ri, duke e klasifikuar në kategorinë e Specialistëve.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me kërkesën e datës 22.04.2025, të parashtruar nga ankuesja, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.*

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e datës 06.05.2025, në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj kërkesën e ankueses të parashtruar me datë 22.04.2025, dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.834/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, Xh.T-G;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.